



Syri i Vizionit

ANALIZË MBI PËRZGJEDHJEN E LËNDËVE ZGJEDHORE NË SHKOLLË



Save the
Children



Sweden

Sverige

ANALIZË MBI PËRZGJEDHJEN E LËNDËVE ZGJEDHORE NË SHKOLLË

NËNTOR, 2019

PËRMBAJTJA

SHKURTESA	3
FALËNDERIME	3
HYRJE	4
RRETH GRUPIT RESPECT OUR RIGHTS - ROR	5
METODOLOGJIA	7
RAPORTI “HENDEKU, KURRIKULA DHE ZBATUESHMËRIA E SAJ”	8
KORNIZA LIGJORE PËR RREGULLIMIN E LËNDËVE ME ZGJEDHJE.....	8
RAPORTI MBI TË DHËNAT E INTERVISTËS PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË PËRZGJEDHJEN E LËNDËVE ZGJEDHORE.....	10
1. CILI ËSHTË QËLLIMI I LËNDËVE ZGJEDHORE?	10
2. SI E RREGULLOJNË KOMUNAT LËNDËN ZGJEDHORE NË ASPEKTIN LIGJOR? .	10
3. LËNDËT ZGJEDHORE QË I PARASHEH KY AKT DHE PËRPUTHJAE TYRE ME QËLLIMIN E MËSIMIT TË KËTYRE LËNDËVE.....	11
4. LËNDËT ZGJEDHORE MË TË SHPESHTA QË ORGANIZOHEN NË SHKOLLA	11
5. KUSH E ZGJEDH LËNDËN ZGJEDHORE?!.....	11
6. MËNYRA E DUHUR E PËRZGJEDHJES SË LËNDËVE ZGJEDHORE	13
7. PAKËNAQËSITË E SHKOLLAVE ME MËNYRËN E PËRZGJEDHJES SË LËNDËVE ZGJEDHORE	13
8. SHKOLLAT KU NXËNËSIT E PËRZGJEDHIN LËNDËN ZGJEDHORE	13
9. KUSH I HARTON PLANPROGRAMET PËR LËNDËT E MËSIMIT ZGJEDHOR?	14
10. VËSHTIRËSITË NË REALIZIMIN E MËSIMIT ZGJEDHOR	14
11. REKOMANDIME.....	16

SHKURTESA

DKA	- Drejtoria Komunale e Arsimit
KDF	- Konventa për të Drejtat e Fëmijës
ROR	- Grupi “Respect our Rights”
MASHT	- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
SCiK	- Save the Children në Kosovë
SiV	- Syri i Vizionit
UA	- Udhëzimi Administrativ

FALËNDERIME

Ky raport u hartua falë kontributit të grupit të vetë-udhëhequr të fëmijëve ROR, të personelit të Save the Children në Kosovë (SCiK) dhe Syrit të Vizionit (SiV) si dhe pjesëmarrësve të hulumtimit tonë.

Falënderojmë drejtorët dhe zyrtarët e tjerë në DKA-të e komunave të anketuara për pjesëmarrje në hulumtim, përmes përgjigjeve në intervistat e zhvilluara, përfshirë atë të Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës, Ferizajt, Fushë Kosovës dhe Malishevës.

Grupi ROR me këtë rast falënderon anëtarët e Komisionit për Arsim në kuadër të grupit, të cilët me përkushtim dhe përgjegjësi të lartë kanë arritur që me kohë të bëjnë mbledhjen e të dhënave nga tereni si dhe përpunimin e tyre në raport.

Falënderim i veçantë i dedikohet edhe mentorëve të grupit, Trina Hoti dhe Ardit Glllogjani e në mënyrë të posaçme mentorit Lekë Morina i cili ka ndihmuar dhe fasilituar punën e komisionit dhe grupit monitorues të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve-Respect Our Right përgjatë hulumtimit dhe përpilimit të këtij raporti, si dhe Shaqir Maliqi për dizajnimin e këtij raporti.

HYRJE

Ky raport është përgatitur nga fëmijët anëtarë të Komisionit për Arsim në kuadër të grupit “Respect our Rights” (ROR), grup ky i themeluar në kuadër të projektit të organizatës Syri i Vizionit (SiV) dhe organizatës Save the Children (SC), si pjesë e programit ‘Qeverisja me të drejtat e fëmijës’. Qëllimi i raportit është të paraqesë të dhëna rreth përbushjes së të drejtave të fëmijëve si dhe të na ofrojë një pasqyrë më të përafërt me realitetin sa i përket nivelit të përbushjes së të drejtave të fëmijëve, kësaj radhe parë dhe argumentuar nga perspektiva e përfaqësuesve të insitucioneve arsimore (DKA-ve) të komunave respodente të këtij hulumtimi.

Ky raport hulumtimi mbi “Përzgjedhjen e Lëndëve Zgjedhore” në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë ka për qëllim nxjerrjen (ekstraktimin) e të dhënave nga perspektiva e insitucioneve e jo të fëmijëve rreth çështjes së përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje, konkretisht konsultimit të mendimeve dhe nevojave të fëmijëve në procesin e përzgjedhjes së lëndëve zgjedhore. Ky hulumtim na ofron një pamje të realitetit në sistemin e arsimit dhe atë se si duhet të bëhet përzgjedhja e lëndëve zgjedhore, si propozohen ato, nga kush dhe si (në realitet) përzgjedhen këto lëndë.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë rrjedhojë e përgjigjeve të zyrtarëve komunalë të arsimit (drejtorëve dhe nëpunësve të DKA-ve) në intervistat e realizuara në insitucionet gjegjëse në komunat Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Skenderaj dhe Malishevë¹.

Andaj, nëpërmjet kësaj analize Grupi ROR sjell të gjeturat dhe rekomandimet e dala në bazë të punës në terren gjatë realizimit të këtij hulumtimi në lidhje me format sesi do të duhej të bëhej propozimi dhe përzgjedhja e lëndëve zgjedhore. përpos të gjeturave nga kjo analizë janë edhe disa rekomandime që kanë dalë se si dhe në çfarë forme do të duhej të bëhet propozimi dhe përzgjedhja e lëndëve zgjedhore të cilat janë obligative për fëmijë/nxënës e që shumë shpesh nuk përkojnë me nevojat dhe propozimet e tyre. . Edhe përkundër këtij fakti, ata janë të detyruar që të mësojnë këto lëndë, edhe pse shumicën prej tyre i kanë edhe lëndë të rregullta apo obligative.

¹ Komuna e Malishevës nuk është përgjigjur në tërë intervistën, përpos që zyrtarët nga kjo Komunë kanë treguar se mësimi zgjedhor organizohet në atë mënyrë që t’u plotësohen orët e munguara mësimdhënësve dhe se pjesëmarrja e nxënësve në këtë proces është relativisht e ulët.

RRETH GRUPIT RESPECT OUR RIGHTS - ROR

Grupi ROR (Respect Our Right) është grupi i parë në Kosovë, i vetë-udhëhequr nga fëmijët që bën monitorimin e zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe ligjeve në fuqi në Kosovë që për qëllim kanë sigurimin e mirëqenies së fëmijëve.

Grupi ROR është themeluar nga OJQ Syri i Vizionit në partneritet me Save the Children dhe përbëhet nga 24 anëtarë të moshave 14-17 vjeç, duke përfshirë edhe fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët i përkasin komunave të ndryshme të Kosovës dhe përkatësive të ndryshme etnike.

Grupi ROR realizon aktivitete që në vazhdimësi promovojnë gjendjen reale të fëmijëve në vend dhe avokojnë tek institucionet përgjegjëse për përmirësimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve. Ky grup ka një bashkëpunim të madh, para së gjithash, me fëmijët, asambleistët e Asambleve Komunale të Fëmijëve në komuna të ndryshme dhe me institucione të larta të vendit. Që nga themelimi i këtij grupi në vitin 2014, Grupi ROR ka qenë nxitës i vetëdijimit shoqëror për ngritjen e mirëqenies së fëmijëve, duke filluar nga zbatimi i të drejtave të tyre në praktikë.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme të Grupit ROR përgjatë këtyre dy viteve të fundit janë:

- Përpilimi i Analizës për Tekstet Shkollore, ku anëtarët e Grupit ROR kanë dalë me disa të gjetura që u prezantuan më pas para zyrtarëve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2017);
- Kryesimi i seancës “Fëmijët udhëheqin Parlamentin”, në Parlamentin e Kosovës për nder të 20 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës, me ç’rast u miratua “Rezoluta për të Drejtat e Fëmijëve” nga votat e fëmijëve si dhe u zhvilluan takime me Kryeministrin dhe Kryeparlamentarin e Republikës së Kosovës dhe iu dorëzua Rezoluta e miratuar dhe diskutuan më gjerësisht me udhëheqësit e vendit për çështjen e fëmijëve në vend (2017);
- Arritja e marrëveshjes së bashkëpunimit me Institucionin e Avokatit të Popullit (2018);
- Organizimi i javës “Çdo ditë është 1 Qershor”, për të shënuar 1 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve (2018);
- Përfaqësimi për herë të parë i Kosovës nga Trina Hoti (ish-kryetare dhe aktualisht mentore) në Javën Europiane për Veprim për Vajza, organizuar nga shumë organizata ndërkombëtare, ndër të tjera edhe nga organizata Save the Children, e mbajtur në Bruksel gjatë vitit 2018 dhe përfaqësimi për të dytën herë me radhë nga Rea Sylejmani (anëtare) gjatë vitit 2019.

Gjatë dy përfaqësimeve janë paraqitur sfidat që vajzat në Kosovë hasin dhe janë mbajtur takime të rëndësishme me institucionet kyçe të BE-së;

- Shënimi i 20 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve me anë të takimit mes fëmijëve të Grupit ROR dhe Kryeparlamentarit të Parlamentit të Kosovës, deputetëve dhe pesë ministrave të qeverisë për të diskutuar për (mos)përmbushjen e kërkesave të Rezolutës për të Drejtat e Fëmijëve e miratuar një vit më parë (2018);
- Reagime të Grupit ROR ndaj grevës së mësimdhënësve në periudhën e janarit të këtij viti; gjuhës diskriminuese në tekstet shkollore të klasës së dytë të arsimit fillor; organizimin e marshimit të parë të fëmijëve në Kosovë kundër ndryshimeve klimatike dhe ngrohjes globale në kuadër të iniciativës globale “Fridays for Future”; bashkëpjesëmarrje në fushatat “Rrite me Dashni” dhe “Voto për Fëmijët”; ndërmarrjen e aktiviteteve avokuese në komunat Pejë, Gjakovë dhe Ferizaj.

Struktura e Grupit ROR përbëhet nga:

Sekretariati - si organi më i lartë i grupi, komisionet me detyrat specifike, mentorët dhe vullnetarët (ish-anëtarë të grupit mbi moshën 18 vjeç).

Komisionet në kuadër të Grupit ROR janë:

1. Komisioni për Arsim,
2. Komisioni për Avokim,
3. Komisioni për Promovimin e punës së ROR-it,
4. Komisioni për Monitorimin e punës së Grupit.

Ky raport është raporti i tretë që grupi jonë ka publikuar pas raportit të parë “Realiteti Ynë” (2014) dhe raportit të dytë “Hendeku, Kurrikula dhe zbatueshmëria e saj” (2018).

METODOLOGJIA

Komisioni për Arsim në kuadër të grupit ROR i ndihmuar edhe nga anëtarët tjerë të këtij grupi janë përgjegjës për zhvillimin e këtij hulumtimi me ndihmën e mentorit të komisionit Lekë Morina, ish-anëtar i këtij grupi.

Fëmijët anëtarë të Grupit gjatë diskutimeve me bashkëmoshatarët e tyre dhe duke qenë pjesë e sistemit edukativo-arsimor, kanë identifikuar si çështje mos-përfshirjen e drejtpërdrejtë të fëmijëve në përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore në shkollat e komunave të tyre.

Target grupi i këtij hulumtimi është caktuar të jenë drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit, pasi që hulumtime rreth çështjes së njëjtë janë zhvilluar edhe më herët nga Grupi ROR (raporti “Realiteti Ynë” dhe “Hendeku, Kurrikula dhe zbatueshmëria e saj”), por me cak të hulumtimit fëmijët, mësimmshënësist dhe drejtorët e shkollave respodente.

Rreth përzgjedhjes së kampionit, Komisioni për Arsim gjatë përgatitjes së këtij hulumtimi, ka vendosur që të jenë drejtorët dhe zyrtarët përgjegjës nga DKA-të e të gjitha komunave prej të cilave fëmijët anëtarë janë pjesë, andaj janë përzgjedhur Prishtina, Peja, Prizreni, Gjakova, Gjiçilani, Mitrovica, Ferizaji, Fushë Kosova, Skenderaji dhe Malisheva.

Mbledhja e të dhënave është bërë nga anëtarët e këtij komisioni nga qytetet përkatëse përmes një interviste të strukturuar me drejtorë të arsimit (në rast mungese të tyre, me zyrtarë të arsimit) të cilët kanë ofruar informata dhe statistika reale sa i përket mënyrës dhe formës së si këto institucione së bashku me shkollat bëjnë përgjedhjen e lëndëve zgjedhore.

Intervista ka përmbajtur pyetje të cilat janë hartuar nga anëtarët e Grupit ROR dhe janë vlerësuar si të nevojshme për të bërë krahasim dhe analizë.

RAPORTI “HENDEKU, KURRIKULA DHE ZBATUESHMËRIA E SAJ”²

Raporti “Hendeku, Kurrikula dhe Zbatueshmëria e saj” i realizuar në vitin 2018, ka pasur qëllim që t’i informojë më gjërësisht DKA-të dhe MASHT-in me disa prej shumë sfidave të reformimit të sistemit arsimor në vend. Kjo kryesisht kishte të bënte me kurrikulën e re të prezantuar në Arsimin Parauniversitar të Kosovës dhe boshllëqet e krijuara nga pjesa teorike e saj dhe zbatimi i saj në praktikë. Ky hulumtim është zhvilluar në formë të pyetësorëve për drejtorë, mësime dhe nxënës të shkollave fillore të mesme të ulëta dhe të shkollave të mesme të larta, në katër (4) komuna të Kosovës, në Prishtinë, Fushë Kosovë, Gjilan dhe Pejë.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë përfshirë edhe pyetje për drejtorë, mësime dhe nxënës të cilat kanë të bëjnë me çështje rregullimative të lëndës zgjedhore, përkatësisht me mënyrën se si bëhet përzgjedhja e lëndës zgjedhore dhe vlerësimi në lëndët zgjedhore.

Të dhënat e dala nga raporti “Hendeku, Kurrikula dhe Zbatueshmëria e saj” janë përdorur edhe në këtë raport për të bërë një analizë krahasimtare në mes të përgjigjeve të dhëna nga drejtorët e shkollave, mësime dhe nxënës - si persona të cilët përballën drejtpërdrejt me këtë çështje, si dhe nga drejtorët e DKA-ve të cilët në mënyrë jo të drejtpërdrejtë janë të informuar mbi këtë problematikë. Këto të dhëna janë përdorur në këtë raport vetëm në krahasimin e përgjigjeve mes komunave responente të njëjta.

KORNIZA LIGJORE PËR RREGULLIMIN E LËNDËVE ME ZGJEDHJE

Kurrikula me bazë shkolle (mësimi me zgjedhje) ka për qëllim që të ndihmojë nxënësit në arritjen e kompetencave kryesore të përcaktuara në dokumentet relevante për rregullimin e mësimi me zgjedhje.

Në aspektin ligjor mësimi me zgjedhje rregullohet nëpërmjet disa dokumenteve, si:

- Korniza Kurrikulare e Arsimi Parauniversitar të Republikës së Kosovës³;
- Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës⁴;
- Kurrikula Bërthamë e Arsimi të Mesëm të Ulët të Kosovës⁵;
- Kurrikula Bërthamë e Arsimi të Mesëm të Lartë të Kosovës⁶;

² Grupi ROR, “Hendeku, Kurrikula dhe Zbatueshmëria e saj”, e qasshme në: http://ror-rks.net/repository/docs/2018_12_19_042627_HendekuKurrikula_dhe_zbatueshmëria_e_saj.pdf

³ MASHT, Korniza Kurrikulare e Arsimi Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar), 2016, e qasshme në: <https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

⁴ MASHT, KURRIKULA BËRTHAMË PËR KLASËN PËRGATITORE DHE ARSIMIN FILLOR TË KOSOVËS, 2016, e qasshme në: <https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

⁵ MASHT, KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS, e qasshme në: <https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-2-final.pdf>

⁶ MASHT, KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË TË KOSOVËS, e qasshme në: <https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-3-final.pdf>

Udhëzimi Administrativ nr. 32/2013 për organizimin e kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (nxjerrë nga MASHT-i)⁷

Sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, mësimi me zgjedhje është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit dhe ofrohet nga shkolla në bazë të interesimit të nxënësve, nevojave të komunitetit, sugjerimeve që ofron MASHT-i dhe mundësi të shkollës. Aty përcaktohet se procedurat e organizimit të kësaj kurrikule rregullohen me dokumente të tjera kurrikulare (siç janë Kurrikulat Bërthamë) dhe me akte nënligjore (Udhëzimi Administrativ).

Sipas Kurrikulave Bërthamë, rezultatet e të nxënësve që duhet të arrihen nga nxënësit dhe metodologjia e realizimit të tyre, hartimi i programit mësimor dhe realizimi i kurrikulës me zgjedhje mbetet kompetencë e shkollës. Vendimi për përcaktimin e Kurrikulës me zgjedhje del si rezultat i një procesi konsultativ, përfshirë nxënësit, prindërit, komunitetin, shkollën dhe komunën. Rreth procedurës së përzgjedhjes dhe miratimit të lëndëve mësimore, moduleve apo projekteve që dalin nga kurrikula me zgjedhje rregullohen me akt nënligjor/udhëzim administrativ të përcaktuar nga MASHT-i.

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 32/2013, shkollave u lejohet autonomi në hartimin e kurrikulës me zgjedhje dhe realizimin e saj në mënyrën dhe formën më të përshtatshme, duke i përkrahur nevojat dhe dëshirat individuale të nxënësve, motivimin e tyre për mësim dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje (neni 1). Për kontekst të këtij hulumtimi, përpos tjerash, i rëndësishëm është neni 6 i këtij Udhëzimi Administrativ, i cili përcakton mënyrën e propozimit dhe përzgjedhjes si dhe neni 8 që përcakton mënyrën e deklarimit.

Sipas nenit 6, propozimin për lëndët, modulet, projektet me zgjedhje mund ta bëjnë: nxënësit, udhëheqja, prindërit, komuniteti, bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës, këshilli i shkollës, DKA-të dhe MASHT. Ndërkaq, përzgjedhjen e bën shkolla në marrëveshje me nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe DKA-në.

Sipas nenit 8, nxënësi paraqitet si akteri kryesor në definimin e lëndës zgjedhore. Shkolla duhet t'iu dorëzojë nxënësve listën e ofertave të lëndëve/moduleve/projekteve zgjedhore, ndërkaq nxënësit duhet të deklarohen për një nga të gjitha ofertat. Pastaj, shkolla përzgjedh dy ofertat më të kërkuara nga nxënësit e të gjitha paraleleve, ndërkaq nxënësit brenda vitit mësimor duhet të mësojnë të paktën njërin nga dy ofertat e përzgjedhura. Në ato shkolla ku lënda/moduli/projekti realizohet brenda një gjysmëvjetori, në gjysmëvjetorin tjetër mund të merret lënda/projekti/moduli i dytë i përzgjedhur më së shumti. Në klasat e arsimit parafillor dhe fillor, përzgjedhja bëhet nga prindërit e nxënësve, ndërkaq në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, përzgjedhja bëhet nga vetë nxënësit.

⁷ MASHT, UDHËZIM ADMINISTRATIV MASHT NR.32/2013 ORGANIZIMI I KURRIKULËS ME ZGJEDHJE NË TË GJITHA NIVELET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

RAPORTI MBI TË DHËNAT E INTERVISTËS PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË PËRZGJEDHJEN E LËNDËVE ZGJEDHORE

CILI ËSHTË QËLLIMI I LËNDËVE ZGJEDHORE?

Lidhur me qëllimin e organizimit të lëndëve zgjedhore në shkolla, të gjitha drejtoritë responente të këtij hulumtimi janë përgjigjur se qëllim parësor është përmbushja e interesave dhe njohurive të nxënësve në fusha/lëmi përkatëse, në të cilat ata kanë nevojë për t'u aftësuar më tepër, poashtu ndihmojnë në orientimin e nxënësve në karrierë, zhvillimin e talenteve të nxënësve si dhe përmbushjen e kompetencave të parapara me kurrikulë.

SI E RREGULLOJNË KOMUNAT LËNDËN ZGJEDHORE NË ASPEKTIN LIGJOR?

Të pyetur se si komunat e rregullojnë mësimin me zgjedhje në aspektin ligjor, në pesë nga komunat e intervistuar ajo bëhet duke u bazuar në udhëzimin administrativ (UA 32/2013) të MASHT-it. Marrë parasysh që udhëzimi administrativ u lejon shkollave autonomi në hartimin e Kurrikulës me zgjedhje dhe ta realizojë atë në formën dhe mënyrën më të përshtatshme⁸, tre nga drejtoritë që janë përgjigjur në këtë hulumtim kanë specifikuar edhe mënyrat e rregullimit të lëndëve me zgjedhje në shkollat e komunës së tyre. Komuna e Mitrovicës dhe Malishevës, kanë treguar se në komunat e tyre, udhëzimi administrativ nuk zbatohet plotësisht dhe kështu organizimi i lëndëve zgjedhore bëhet në koordinim me mësimdhënësit të cilët kanë mungesë të orëve (normës së plotë) mësimore. Ndërkaq, në Komunën e Skenderajt rregullimi i lëndëve zgjedhore bëhet duke i marrë mendimet e nxënësve.

LËNDËT ZGJEDHORE QË I PARASHEH KY AKT DHE PËRPUTHJAE TYRE ME QËLLIMIN E MËSIMIT TË KËTYRE LËNDËVE

Sa i përket çështjes se cilat janë lëndët zgjedhore të parapara me aktin juridik nëpërmjet të cilit ata i rregullojnë lëndët zgjedhore në Komunën e tyre, kemi marrë përgjigje të ndryshme, pavarësisht faktit se të gjithë në pyetjen paraprake janë përgjigjur se çështjen e lëndëve zgjedhore e rregullojnë me Udhëzimin Administrativ.

Komuna e Prishtinës, Pejës, Gjakovës dhe ajo e Ferizajt nuk kanë dhënë përgjigje të qartë se cilat janë lëndët specifike të propozuara nga akti juridik përkatës dhe të implementuara në shkollat e komunës së tyre. Ato kanë thënë se këto lëndë janë në funksion të realizimit të objektivave dhe qëllimeve mësimore, porse ato ndryshojnë varësisht nga interesimet dhe nevojat e nxënësve dhe se lënda zgjedhore nuk duhet të ketë planprogram apo nuk duhet të jetë në përmbajtje dhe tërësi e njejtë sikurse lëndët bazike.

Përkundër komunave të lartpërmendura, Komuna e Mitrovicës dhe ajo e Skenderajt i kanë të përcaktuara lëndët zgjedhore të cilat aplikohen në shkollat e komunës së tyre.

Në *Komunën e Mitrovicës*, lëndë zgjedhore janë: TIK, Art Interpretimi, Mbrojtje e Mjedisit etj.

⁸ Udhëzimi Administrativ 32/2013 - Organizimi i Kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, fq. 1, neni 1. i qasshëm online në vegzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10157>

Ndërkaq, në **Komunën e Skenderajt**, si lëndë zgjedhore janë përcaktuar: Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK), Mjedisi Jetësor, Module nga shkencat natyrore, sporte apo arte.

LËNDËT ZGJEDHORE MË TË SHPESHTA QË ORGANIZOHEN NË SHKOLLA

Në pyetjen se *“Cilat janë lëndët zgjedhore më të shpeshta që organizohen në shkollat e komunës suaj dhe sa mendoni që janë të nevojshme ato?”*, në tre nga komunat të përgjigjura në hulumtimin tonë kanë deklaruar se lëndët zgjedhore përcaktohen në bazë të interesimit të nxënësve dhe drejtimit të cilit ata i përkasin. **Komuna e Gjakovës**, ka përmendur një shembull kur në shkollën e mesme profesionale ekonomike në këtë komunë, nxënësit kanë përzgjedhur lëndën *“Ekonomia dhe Ndërmarrësia”*, marrë parasysh ngjashmërinë mes drejtimit të studimeve të tyre dhe lëndës përkatëse.

Shembuj të ngjashëm janë dhënë edhe nga komunat e tjera, ku janë përgjigjur se nxënësit e drejtimeve të shkencave natyrore janë më të orientuar në lëndë zgjedhore të cilat kanë të bëjnë me shkenca natyrore, apo ata të drejtimit të shkencave shoqërore janë të orientuar në lëndë zgjedhore të ngjashme me drejtimin.

Nga përgjigjet që kemi siguruar nga ky hulumtim, vetëm Komuna e Prishtinës, Skenderajt dhe Prizrenit janë përgjigjur në mënyrë specifike se cilat janë lëndët zgjedhore më të shpeshta që realizohen në këto komuna. **Në Komunën e Prishtinës** është thënë që në shumicën e shkollave të kësaj komune, lëndët zgjedhore më të shpeshta janë: Etika, Shkathtësitë e shek. XXI, Ekologjia, Aftësi për Jetën e të tjera. **Në Komunën e Prizrenit** si më të shpeshta kanë listuar lëndët: Mirëqenia dhe Shëndeti, Teknologjia, Lëndë të tjera shkencore dhe Gjuhët dhe Komunikimi (kryesisht Gjuha Angleze). Ndërkaq **në Komunën e Skenderajt**, janë përgjigjur se lëndët zgjedhore më të shpeshta janë TIK dhe Mbrojtja e Mjedisit.

Edhe pse disa nga komunat e intervistuar janë përgjigjur specifikisht se cilat lëndë zgjedhore realizohen në shkollat e komunës së tyre, është vlerësuar e nevojshme të merren edhe informacione se sa DKA-të janë të njoftuara me nivelin e kënaqshmërisë dhe interesimit të nxënësve me këto lëndë të cilat janë të përcaktuara qoftë nga MASHT-i, DKA apo nga vetë shkolla. Në pyetjen se *a është bërë ndonjëherë nga ana e tyre ndonjë hulumtim se për cilat lëndë zgjedhore kanë nevojë nxënësit*, të gjitha DKA-të e intervistuar janë shprehur që asnjëherë nuk kanë zhvilluar ndonjë hulumtim të tillë, por kanë monitoruar procesin e përcaktimit dhe përzgjedhjes së lëndëve zgjedhore si dhe të zbatueshmërisë së udhëzimit administrativ në fjalë. Të vetmet të dhëna (jozyrtare) empirike të cilat disa prej DKA-ve i posedojnë, janë ato të përgjigjeve të nxënësve se për cilën lëndë zgjedhore përcaktohen në ato raste kur ata pyeten, prej të cilave matin vetëm interesimin e nxënësve nëpërmjet numrit, pra sa nxënës përcaktohen në një lëndë të veçantë.

KUSH E ZGJEDH LËNDËN ZGJEDHORE?!

Sa i përket pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje, sidomos kur bëhet fjalë për përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore, zyrtarët e Drejtorive Komunale të Arsimit të komunave të intervistuar kanë dhënë përgjigje dhe alternativa të ndryshme.

Se kush merr pjesë në përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore, zyrtarët komunal të DKA-së **në Komunën e Prishtinës**, janë përgjigjur se “*aktivet profesionale janë përgjegjëse për përzgjedhjen e lëndëve, moduleve dhe projekteve më të mira për deklarim/pëlqim në interes të nxënësve në mënyrë transparente dhe sipas kritereve të njëjta për të gjithë konkurentët*”. Komisioni i shkollës për Kurrikulë me zgjedhje (i përbërë nga 3 anëtarë) është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit brenda shkollës dhe i raporton drejtorit të shkollës, ndërkaq drejtori i shkollës është përgjegjës për rregullsinë e procesit të përzgjedhjes së Kurrikulës me Zgjedhje, i cili më pas i raporton DKA-së. Ngjashëm është përgjigjur edhe **Komuna e Gjilanit**, të cilët kanë deklaruar se Kurrikula me Zgjedhje përcaktohet nga aktivet profesionale.

Në Komunën e Pejës janë përgjigjur se çështja e përzgjedhjes së lëndës zgjedhore është e ndërvarur dhe se në këtë proces nuk merr pjesë DKA. Përzgjedhja e këtyre lëndëve në këtë komunë varet nga njëra anë nga mundësitë, kapacitetet dhe kuadri profesional që ka dhe ofron shkolla dhe nga ana tjetër nga interesimi i nxënësve. Në Komunën e Pejës shkolla propozon disa lëndë zgjedhore (të cilat u përshtaten kushteve të lartpërmendura) të cilat më pas *nxënësit* nëpërmjet votës së tyre përzgjedhin një nga këto lëndë. Për të përzgjedhur një lëndë të caktuar kërkohet vota e më tepër se 50% të nxënësve të klasës. Përpos kësaj mundësie, ofrohen edhe alternativa të tjera. Në qoftë se gjysma tjetër e klasës ka votuar për një subjekt tjetër të lëndës zgjedhore, atëherë mund të ndodh që kësaj pjese i sigurohet hapësira dhe mësimdhënësi për realizimin e orës, mirëpo është thënë se kjo alternativë ekziston por jo gjithëherë është efikase dhe realizohet në praktikë. Gjithashtu, është deklaruar se ka raste kur nxënësve u servohen lëndët zgjedhore pa i pyetur ata dhe kjo vetëm për t’ua plotësuar orët e nevojshme mësimdhënësve.

Ndërkaq, **në Komunën e Fushë Kosovës** janë përgjigjur se lëndën zgjedhore e përzgjedhin *nxënësit dhe prindërit*, në bashkëpunim (me propozim) me mësimdhënësit e shkollës.

Përgjigjet e zyrtarëve komunal të arsimit, krahasuar me të dhënat e dala nga raporti “Hendeku, Kurrikula dhe Zbatueshmëria e saj”, na lënë të kuptojmë se në këto komuna *përzgjedhja e lëndës zgjedhore më së paku bëhet nga fëmijët*. Në raportin e përmendur, 37% e nxënësve të anketuar janë përgjigjur se ato lëndë kryesisht i zgjedhin mësimdhënësit/drejtori, 33% nuk e dinë se kush, ndërkaq vetëm 7% e tyre kanë thënë se i zgjedhin ata vetë personalisht. Në anën tjetër 45% e mësimdhënësve të anketuar janë përgjigjur se lëndët zgjedhore i përzgjedh Këshilli i Mësimdhënësve, rreth 14% e tyre janë deklaruar se ato i përzgjedh DKA, ndërkaq një numër i vogël i tyre (5%) kanë deklaruar se ato i zgjedh MASHT-i. Drejtorët e anketuar, në masë të madhe (57%) kanë deklaruar se ato i përzgjedh Këshilli i Mësimdhënësve apo DKA-të, përkundër 29% e tyre që kanë thënë se ato i përzgjedh Këshilli i Nxënësve.

Në anën tjetër, **në Komunën e Mitrovicës** kanë deklaruar drejtpërdrejt se në shkollat e komunës së tyre përcaktimi i lëndëve zgjedhore bëhet nga *drejtori i shkollës* në bashkëpunim (me propozim) me mësimdhënësit e shkollës, gjersa kanë treguar se janë të vetëdijshëm se ky proces do duhej të realizohej nga vetë nxënësit.

Në Komunën e Skenderajt janë përgjigjur se lëndën zgjedhore e përzgjedhin *nxënësit dhe mësimitdhënësit*. *Në Komunën e Gjakovës* është thënë se përzgjedhja bëhet poashtu nga *nxënësit* dhe kjo nëpërmjet propozimeve të shkollës për disa lëndë dhe pastaj nëpërmjet shumicës së votave të nxënësve vendoset cila paralele çfarë lënde zgjedhore e përzgjedh. Është thënë se ekziston mundësia që nëse interesimi i nxënësve është i lartë, lënda zgjedhore mund të ndahet në dy subjekte të cilat zhvillohen të ndara në gjysmëvjetore.

Në Komunën e Ferizajt, ngjashëm sikurse në Komunën e Pejës është thënë se në këtë proces marrin pjesë *nxënësit* dhe kjo bëhet nëpërmjet të pyetësorëve.

Ndërkaq, *në Komunën e Prizrenit* janë përgjigjur se vendimmarrja në përzgjedhjen e lëndës zgjedhore bëhet në mënyrë kolektive, ku marrin pjesë: *nxënësit, mësimitdhënësit, prindërit, organet profesionale të shkollës*, ndërkaq ato lëndë i miraton Këshilli i Shkollës si organi më i lartë.

MËNYRA E DUHUR E PËRZGJEDHJES SË LËNDËVE ZGJEDHORE

Edhe pse shumë nga respondentët në pyetjen paraprake janë përgjigjur se *nxënësit* janë ata të cilët kryesisht vendosin, në pyetjen se “si konsideroni se është mënyra më e duhur për përzgjedhjen e lëndës zgjedhore”, kemi pranuar propozime pothuajse të ngjashme.

Përderisa, zyrtarët nga DKA e Komunës së Prishtinës janë përgjigjur se “*ka aspekte të shumta që duhet përmirësuar*”, Komuna e Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës, Prizrenit, Ferizajt, dhe Skenderajt kanë sugjeruar që mënyra më e mirë do ishte në qoftë se akti juridik (Udhëzimi Administrativ respektivisht) zbatohet në përpikmëri nga shkolla, që nënkupton se përzgjedhja e lëndëve zgjedhore të bëhet nga *nxënësit* në bashkëpunim me organet profesionale të shkollës.

PAKËNAQËSITË E SHKOLLAVE PËR MËNYRËN E PËRZGJEDHJES SË LËNDËVE ZGJEDHORE

Edhe pse shumë nga DKA-të e intervistuar kanë deklaruar se sa i përket organizimit të lëndëve zgjedhore ata bazohen në udhëzimin administrativ në fuqi, në pyetjen se “*a ka ndonjë shkollë në komunën e tyre që është e pakënaqur me mënyrën e përzgjedhjes së lëndëve zgjedhore*”, disa nga to kanë deklaruar se kanë pasur ankesa nga disa institucione shkollore rreth kësaj çështjeje.

Komuna e Prishtinës, ka siguruar një shembull kur një shkollë në këtë komunë ka deklaruar se më mirë sipas tyre do të ishte që shkolla vetë të bënte përzgjedhjen e mësimit me zgjedhje pa ndërhyrjen e DKA-së dhe akterëve tjerë.

Komuna e Mitrovicës është shprehur se në komunën e tyre ka disa shkolla të cilat nuk janë të kënaqura me mënyrën e përzgjedhjes së lëndëve zgjedhore, por se në çfarë aspekti ka mospajttime, nuk është dhënë ndonjë hollësi.

Ndërkaq zyrtarët nga *Komuna e Skenderajt* janë përgjigjur se kanë pranuar ankesa individuale rreth kësaj çështjeje, por jo nga ndonjë shkollë në tërësi.

SHKOLLAT KU NXËNËSIT PËRZGJEDHIN LËNDËN ZGJEDHORE

Në krahasimin e përgjigjeve mes kësaj pyetjeje dhe pyetjes së mëhershme se kush vendosë për përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore mund të vërehen kontradikta. Përderisa në pyetjen e mëparshme vërejtëm se disa komuna ishin deklaruar se për përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore pyeten aktivet profesionale (në Komunën e Prishtinës dhe Gjilanit) apo përzgjedhja në mënyrë kolektive nga nxënësit, mësimdhënësit, prindërit, organet profesionale të shkollës (Komuna e Prizrenit, Skenderajt, Fushë Kosovës).

Lidhur me pyetjen se *a ka ndonjë shkollë në të cilën nxënësit bëjnë vetë përzgjedhjen e lëndës zgjedhore*, rezultatet e përgjigjeve kanë dalë të ngjashme sikurse ato të pyetjes se kush merr vendim në përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore. Pothuajse të gjitha DKA-të e intervistuarat kanë deklaruar se nxënësit marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes kur ka të bëjë me lëndët zgjedhore, përpos ***në Komunën e Mitrovicës*** të cilët qysh në fillim janë deklaruar se lënda zgjedhore përcaktohet nga mësimdhënësit dhe drejtori i shkollës.

KUSH I HARTON PLANPROGRAMET PËR LËNDËT E MËSIMIT ZGJEDHOR?

Kur është parashtruar pyetja se kush i harton planet dhe programet për lëndët e mësimin zgjedhor, të gjitha DKA-të pjesëmarrëse të këtij hulumtimi janë përgjigjur se ato hartohen nga mësimdhënësit përkatës të lëndës të cilën ata e ligjërojnë.

Në Komunën e Prishtinës dhe atë ***të Prizrenit*** kryesisht nga *mësimdhënësit* e lëndës, por ka raste kur ato hartohen edhe nga *aktivi i lëndës/fushës përkatëse*, ndërkaq në Komunën e Gjilanit janë përgjigjur se ato kryesisht hartohen nga *menaxhmenti i shkollës*.

Në disa shkolla ***të Komunës së Skenderajt***, planet dhe programet hartohen nga *mësimdhënësit* dhe *një grup i pedagogëve*.

Kur janë pyetur nëse nxënësit marrin pjesë ndonjëherë në hartimin e planeve dhe programeve të lëndëve zgjedhore, qoftë duke propozuar heqjen/ndryshimin/shtimin e ndonjë njësie mësimore, ne kemi pranuar përgjigje të ndryshme nga DKA-të e intervistuarat. Zyrtarët e DKA-së së ***Komunës së Ferizajt*** në përgjigjen e tyre nuk kanë qenë të qartë në qoftë se nxënësit ndërhyjnë ose jo, por kanë konsideruar se përderisa nxënësit përzgjedhin lëndën zgjedhore, atëherë atyre do u takonte që edhe të bëjnë ndryshim/plotësime në planet dhe programet e lëndës. Edhe zyrtarët nga komunat e tjera të intervistuarat kanë konsideruar se është e nevojshme që edhe nxënësit të kontribuojnë në përmirësimin e planeve dhe programeve të lëndës dhe se ata janë të lirë për ta bërë një gjë të tillë, por janë shprehur që ata (nxënësit) nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces. Në anën tjetër mësimdhënësit e lëndës janë të angazhuar në identifikimin e problemeve të mësimnxënies së nxënësve dhe mundohen të mënjanojnë këto vështirësi duke i marrë parasysh interesat dhe kapacitetet e të nxënësve dhe kjo bëhet nëpërmjet zgjedhjes së përmbajtjes të cilën vlerësojnë se nevojiten më tepër për nxënës.

VËSHIRËSITË NË REALIZIMIN E MËSIMIT ZGJEDHOR

Një ndër objektivat kryesore të realizimit të këtij hulumtimi ka qenë identifikimi i problemeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies në lëndët zgjedhore. Gjatë diskutimeve dhe takimeve të grupit ROR me fëmijë të ndryshëm nga regjione të ndryshme të Kosovës si dhe gjatë hulumtimeve të ngjashme të cilat i ka realizuar ky grup në terren, si dhe duke marrë parasysh faktin që të gjithë anëtarët e këtij grupi janë nxënës qoftë të shkollave fillore apo të mesme, kanë arritur t'i identifikojnë edhe vetë sfidat në realizimin e suksesshëm të Kurrikulës me Zgjedhje. Disa prej këtyre sfidave të cilat i kanë identifikuar edhe fëmijët (nxënësit) janë të njohura edhe për disa prej DKA-ve responente të këtij hulumtimi dhe të njëjta me mendimet e fëmijëve.

Zyrtarët e DKA-së në **Komunën e Prishtinës** kanë deklaruar se në shkollat e komunës së tyre ka shumë vështirësi në realizimin e lëndës me zgjedhje. Ata kanë radhitur disa nga ato vështirësi, duke përmendur fillimisht:

- *mungesën e planeve vjetore, mujore apo përmbajtjes adekuate të lëndës;*
- *mungesën e literaturës konkrete duke u bazuar kështu në burime të pacaktuara dhe shpesh nuk dihet nëse përputhen burimet e materialeve mësimore me nivelin e nxënësve;*
- *paraqitja e projekteve të njëjta për klasë dhe nivele të ndryshme; titujt e përgjithshëm apo të ngjashëm me titujt e lëndëve bazike si dhe*
- *orët e padefinuara të mësimit zgjedhor për nxënësit e klasëve të 9-ta. Zyrtarët e kësaj komune konsiderojnë se këto vështirësi ndikojnë kryesisht në planifikim-realizim.*

Poashtu, kanë shtuar se

- *përmbajtja joadekuate për nivelin e njohurive, vlerave dhe qëndrimeve ndikon në arritjen e kompetencave që synohen për nivelin shkollor, përderisa nuk kanë dhënë ndonjë sugjerim se si të tejkalohen këto vështirësi.*

Në **Komunën e Gjilanit** kanë deklaruar se problemet e vetme të cilat atyre u paraqiten janë *mungesa e hapësirave* për realizimin e këtyre orëve, e kryesisht kabineteve të posaçme. Ata kanë shtuar se këto probleme ndikojnë në nivelin e mësimdhënies dhe se problemet e tilla duhet të zgjidhen nëpërmjet angazhimit të përbashkët të niveleve të ndryshme në zinxhirin e arsimit.

Edhe **Komuna e Prizrenit** është shprehur ngjashëm sikurse Komuna e Prishtinës, duke theksuar se problemet kryesore të tyre janë:

- *mungesa e literaturës dhe mjeteve didaktike për lëndën e caktuar zgjedhore, si dhe*
- *mungesa e trajnimeve për mësimdhënësit e këtyre lëndëve, pasi që mungesa e njohurive të nevojshme të mësimdhënësve bën të pamundur përcjelljen e plotë të informacioneve tek nxënësit dhe në këtë mënyrë paraqiten probleme në mësimnxënie.*

Marrë parasysh që organizimi i trajnimeve të tilla është nën kompetenca të MASHT-it, ata konsiderojnë se zgjidhja e këtij problemi do ishte angazhimi i MASHT-it në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

DKA në **Komunën e Pejës** ka theksuar se një ndër problemet kryesore për realizimin e këtyre orëve është *mungesa e burimeve materiale të informacionit* dhe në këtë mënyrë mësimdhënësit detyrohen që të shfrytëzojnë burimet e tjera të informacionit siç janë interneti, projektet e realizuara nga nxënësit, materiale nga lëndët primare etj. Sipas tyre, mungesa e këtyre burimeve ndikon në mësimnxënie të nxënësve, prandaj sugjerojnë që në rast të paraqitjes së këtyre problemeve të mos përzgjedhet ajo lëndë. Konsiderohet se kjo vështirësi mund të tejkalohet vetëm nëse udhëzimi administrativ respektohet me përpikmëri.

Ndër përgjigjet e pranuar nga DKA-të e intervistuar, ne kemi hasur edhe në disa komente të komunave të cilat kanë deklaruar se mësimdhënësit nuk kanë vështirësi konkrete në realizimin e orëve të lëndëve zgjedhore.

Komuna e Gjakovës ka theksuar se ata nuk kanë hasur asnjëherë në vështirësi për të siguruar hapësirat e nevojshme shkollore e as mësimdhënësit e kualifikuar, ndërkaq nuk kanë deklaruar nëse mësimdhënësit kanë ndonjë vështirësi në realizimin me sukses të këtyre lëndëve.

Komuna e Mitrovicës ka deklaruar se problemi i vetëm sa i përket realizimit të mësimi zgjedhor, paraqitet në kohën kur *përcaktohen mësimdhënësit e lëndës zgjedhore dhe realizimi i normës së orëve të tyre* respektivisht. Zyrtarët e kësaj komune nuk janë shprehur specifikisht në qoftë se ka ndonjë problem tjetër gjatë realizimit të këtyre orëve. Marrë parasysh që nxënësit nuk e përzgjedhin vetë lëndën zgjedhore në shkollat e kësaj komune, zyrtarët e DKA-së në Mitrovicë kanë deklaruar se kjo paraqet një problem mjaft të madh sidomos në mësimnxënie, sepse lënda e përzgjedhur nuk ka rrjedhur nga vullneti apo interesimi i nxënësve, prandaj edhe paraqiten probleme të tilla. Ata sugjerojnë se rritja e bashkëpunimit mësimdhënës-nxënës dhe ndryshimi i mënyrës së përzgjedhjes së lëndës zgjedhore-përzgjedhja nga nxënësit përkatësisht, do ndikonte dukshëm në tejkalimin e këtyre problemeve.

Edhe **Komuna e Ferizajt** është shprehur se nuk ekziston ndonjë problem tjetër në realizimin e orëve zgjedhore, pos *vështirësive në hartimin e planeve dhe programeve shkollore*, pasi që lënda zgjedhore është lëndë e cila nuk duhet të ketë përmbajtje të njëjtë me lëndët bazike. Ata kanë konsideruar se *mungesa e hulumtimit dhe bashkëpunimit të mësimdhënësve* janë dy nga faktorët të cilët ndihmojnë në shprehjen e këtij problemi dhe kjo rrjedhimisht ndikon në mësimnxënie. Sugjerimi i tyre është që pikërisht të rritet bashkëpunimi mes mësimdhënësve dhe të jenë më hulumtues gjatë përpilimit të planeve dhe programeve mësimore të lëndës përkatëse.

REKOMANDIME:

Sipas të dhënave të dala nga hulumtimi i kryer me zyrtarë të DKA-ve në komunat Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren, Ferizaj, Fushë Kosovë, Malishevë dhe Skenderaj lidhur me procesin e përzgjedhjes së lëndëve zgjedhore, Komisioni për Arsim në kuadër të Grupit ROR ka nxjerrë këto rekomandime:

- DKA-të dhe shkollat duhet të bëjnë përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ dhe të reflektojnë mbi zbatimin e saj;
- MASHT duhet të monitorojë dhe t'u ofrojë ndihmë DKA-ve dhe shkollave në zbatimin e UA-së;
- MASHT duhet të ofrojë trajnime profesionale të mjaftueshme për mësimdhënësit e lëndëve zgjedhore në ngritjen e kapaciteteve të tyre, me ç'rast kjo do ndikonte edhe në ngritjen e cilësisë së mësimin;
- MASHT dhe DKA-të duhet të sigurojnë literaturën bazë dhe materialet konkretizuese të nevojshme në realizimin e mirëfilltë të lëndëve zgjedhore;
- Përderisa ekziston boshllëku mes lëndës dhe literaturës së saj, mësimdhënësit duhet të angazhohen më tepër që të hulumtojnë për literatura të reja, të përditësuara, të sigurta dhe të përshtatshme për nivelin e fëmijëve;
- DKA-të dhe shkollat në bashkëpunim me strukturat e shkollave dhe OJQ-të lokale duhet të realizojnë hulumtime për identifikimin e të metave në lëndët zgjedhore aktuale apo për të parë nevojat dhe interesimet për mësimin zgjedhor dhe të avokojnë tek MASHT për ndryshim/plotësim/ndërrim të lëndëve/moduleve/projekteve zgjedhore në rast nevojë;
- Shkollat dhe DKA-të duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të fëmijëve në këtë proces dhe kjo duke marrë parasysh gjithnjë mendimin e fëmijëve dhe duke konsideruar faktin dhe të drejtën e fëmijëve si vendimmarrës në gjithë këtë proces;
- DKA-ja duhet të promovojë dhe nxisë shkollat që të përfshijnë nxënësit në përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore;
- Shkolla dhe mësimdhënësit të rritin bashkëpunimin me fëmijët në hartimin e plan-programeve të lëndëve zgjedhore. Ky angazhim duhet të bëhet përgjatë gjithë vitit, ku mësimdhënësit gjithnjë marrin të dhëna se sa është arritur mësimnxënia, por edhe në fund të vitit mund të realizohet nëpërmjet të pyetësorëve se çfarë do donin fëmijët të ndryshonin në lëndën e dhënë dhe t'u ofrohet mundësia për kontribut në hartim të planprogrameve.



Ky material/botim është
financuar nga Qeveria e Suedisë.
Përgjegjësine për përmbajtjen e
këtij materiali e mban
plotësishtë hartuesi. Qeveria e
Suedisë nuk ndan meddoemos
pikëpamjet dhe interpretimet e s
hprehura në këtë botim"

Syri i Vizionit
Rr.Isa Demaj nr.14
+383 (0) 39 42 32 240
info@syriivizionit.org
www.syriivizionit.org

Save the Children në Kosovë
Rr. Gazmend Zajmi nr.1
+383 (0) 38 23 26 91
scik@savethechildren.org
www.kosovo.savethechildren.net

Respect Our Right - ROR
info@ror-rks.net
www.ror-rks.net